



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede,
Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural
Development**

DOKUMENT KONSULTIMI
PËR PROJEKT UDHËZIMIN ADMINISTRATIV (MBPZHR) – NR
XX/2022 PËR KUSHTET DHE KËRKESAT TEKNIKE QË DUHET
PLOTËSUAR NGA STREHIMORET E KAFSHËVE SHOQËRUESE

Përmbledhje e shkurtër për hartimin e Projekt Udhëzim Administrativ (MBPZHR) – Nr. xx/2022 për Kushtet dhe kërkesat teknike që duhet plotësuar nga Strehimoret e Kafshëve Shoqëruese.

Arsyeja për hartimin e këtij Projekt Udhëzimi Administrativ është krijimi i një baze ligjore për Kushtet dhe kërkesat teknike që duhet plotësuar nga Strehimoret e Kafshëve Shoqëruese.

Ky projekt Udhëzim Administrativ është në përputhshmëri me nenin 4 paragrafi 4.2 dhe Nenit 15 paragrafi 15.2 dhe Nenit 18 paragrafi 18.1 të Ligjit Nr. 02/L-10 për Përkujdesjen Ndaj Kafshëve (Gazeta Zyrtare e Republikaës së Koovës, Nr. 5/01. 10.2006) dhe sipas Nenit 13 të Ligjit Nr. 2004/21 për Veterinarinë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/01, Nëntor 2007), Neni 8, paragrafi 1.4 i Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të ministrive (30..03.2021) si dhe Neni 38 paragrafi 6 i Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr. 15, 12.09.2011),

Përshkrimi i shkurtër i çështjes

Ministria përgjegjëse për çështjet e bujqësisë ka hartuar projekt udhëzimin që do të zbatohet nga organet kompetente.

Qëllimi i konsultimit

Qëllim kryesor i konsultimit është vënia ne dispozicion te publikut, projekt udhëzimin administrativ që i përcakton Kushtet dhe kërkesat teknike që duhet plotësuar nga Strehimoret e Kafshëve Shoqëruese.

Për këto dhe për arsye të tjera, Qeveria e Republikës së Kosovës, ka konsideruar që forma më e mirë e procesit të politikë bërjes në aspektin legjislativ, është konsultimi i hershëm me grupet e interesit, të cilat në një mënyrë apo tjetër, ndikojnë drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së këtij Projekt udhëzimi administrativ.

Procesi i konsultimeve me grupet e interesit do të bëhet në formë të shkruar, ku në mënyrë të detajuar, do të bëhen pyetjet për çështjet e propozuara. Përveç pyetjeve të cilat ne si organ propozues i kemi caktuar, grupet e interesit, do të kenë mundësinë të propozojnë edhe çështjet tjera të cilat mendojnë se janë të rëndësishme dhe të nevojshme për diskutim. Ofrimi i përgjigjeve të qarta dhe të argumentuara, do të kontribuonte drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së projekt udhëzimit administrativ të propozuar. Të gjitha komentet, rekomandimet, alternativat tuaja të propozuara në këtë projekt udhëzimit administrativ, ne si institucion propozues, do t'i analizojmë dhe në afatin sa më të shkurtër, do të mundohemi t'i inkorporojmë pa e cenuar materien e këtij projekt udhëzimit administrativ. Projekt udhëzimit administrativ përfundimtar së bashku me tabelën informuese, do t'ua përcjellim të gjitha grupeve të përfshira në konsultim.

Afati përfundimtar për dorëzimin e përgjigjeve është 09 Nëntor 2022

Afati përfundimtar i dorëzimit të kontributit me shkrim në kuadër të procesit të konsultimit, për Projekt Udhëzim Administrativ (MBPZHR) – Nr. xx/2022 Kushtet dhe kërkesat teknike që duhet plotësuar nga Strehimoret e Kafshëve Shoqëruese. është nga data **20 Tetor 2022 deri më 09 Nëntor 2022**.

Të gjitha komentet e pranuar deri në këtë afat do të përmbliidhen nga ana e personit përgjegjës.

Të gjitha kontributet me shkrim duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: isuf.cikaqi@rks-gov.net; isah.rudaku@rks-gov.net me titull “*Projekt Udhëzim Administrativ (MBPZHR) – Nr. xx/2022 për Kushtet dhe kërkesat teknike që duhet plotësuar nga Strehimoret e Kafshëve Shoqëruese*”

Ju lutemi që në kuadër të kontributit tuaj me shkrim, të specifikoni qartë së në çfarë cilësie jeni duke kontribuar në këtë proces konsultimi (p.sh. në cilësi të përfaqësuesit të institucionit, organizatës, kompanisë, në cilësi individuale, etj.)

Komentet nga institucionet-organizatat

Ju lutem, që komentet tuaja të ofrohen sipas udhëzimeve të shënuara si ne vijim:

Emri i institucionit/organizatës që jep komente:

KSAVA – (KOSOVO SMALL ANIMAL ASSOCIATION) – ORGANIZATA VETERINARE PËR KAFSHËT E SHOQËRIMIT

Fushat kryesore të veprimit të institucionit/organizatës:

KSAVA – është një shoqate profesionale për veteriner e cila i kushtohet mjekësisë veterinare të kafshëve shoqëruese.

Informatat e kontaktit të institucionit/organizatës:

**RR. Shpetim Robaj 227, Prishtine, kosovo.sava@gmail.com & dardan.pozhegu@gmail.com
– 044/248-780 & 049-217-917**

Data e dërgimit të komenteve: 07.11.2022

Forma e kontributit është e hapur, mirëpo preferohet që kontributet tuaja t’i përfshini në kuadër të tabelës së bashkëngjitur si ne vijim në këtë dokument, e cila përfshin çështjet kyçe të këtij dokumenti.

	Çështjet kyçe	Komente rreth draftit aktual	Komente shtesë
1.	<i>Çka mendoni për Projekt Udhëzim Administrativ (MBPZHR) – Nr. xx/2022</i>		

	<i>për Kushtet dhe kërkesat teknike që duhet plotësuar nga Strehimoret e Kafshëve Shoqëruese.!</i>		
2.	<i>çka mendoni për kushtet dhe kërkesat teknike të strehimoreve të kafshëve shoqëruese!</i>	<p>Neni 14/4</p> <p>Tek ky nen mendojmë, që duhet të shtohet teksti (klauzola) që pronari i një kafshe të regjistruar, nuk ka të drejtë të heq dore nga kafsha, perveq nesë ndrrohet pronari. Poashtu duhet të jetë bartës i të gjitha shpenzimeve për kafshën e tij.</p>	
3.	<i>A mendoni se është përshkruar çartë Përkujdesja ndaj kafshëve shoqëruese në strehimore!</i>	<p>Neni 23 - pika 3, bjen në kontradiktë me pikën 2, për arsye sepse, nëse qeni është agresiv dhe ka sëmundje të rënda të pashërueshme, lëndime të rënda trupore, crregullime psikike të pakthyeshme, nuk ka nevojë të mbahet për 15 dite te tjera nga pranimi .</p> <p>Neni 23/4 mendojmë se nuk duhet të ekzistoj fare sepse, e para është kontradikte e nenit 14/4 dhe poashtu nëse pranohet plotësimi i nenit 14/4 sipas propozimit tonë, ky nen duhet të largohet, (sepse kafshët nuk mirren për te plotësuar egot/dëshirat disa ditore/javore dhe pastaj të braktisen. Ne si KSAVA nuk pranojmë të bëjmë eutanazinë</p>	

		e kafsheve të shëndeteshme të braktisura nga pronarët e pandërgjegjshëm.	
4.	<i>A mendoni se është përshkruar çartë Procedura e adoptimit dhe informacionet mbi kafshët që do të jenë në dispozicion për publikun!</i>		
5.	<i>A mendoni se është përshkruar çartë hapësirat në strehimore!</i>		
6.	<i>A mendoni se është përshkruar çartë Mënyren e përkujdesjes së kafshëve në strehimore!</i>		
7.	<i>A mendoni se është përshkruar çartë Kontrolla, parandalimi dhe trajtimi!</i>		

Bashkëngjitur me këtë dokument, gjeni “Projekt Udhëzim Administrativ (MBPZHR) – Nr. xx/2022 Kushtet dhe kërkesat teknike që duhet plotësuar nga Strehimoret e Kafshëve Shoqëruese.”